



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJU
DEPARTMENT OF GENERAL ADMINISTRATION

Tel / Fax: 0290/321-811
e-mail: dreadpers@gmail.com
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

PLANI I PUNËS

për periudhën 1 Janar 2025 - 31 Dhjetor 2025

Përgatitja e planit vjetor të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është bazuar në specifikimin e qëllimeve, synimeve dhe objektivave mbi baza mujore, tremujore, gjashtëmujore e vjetore:

- Udhëheqja e drejtorisë në përputhje me dispozitat ligjore, aktet nënligjore, statutin dhe rregulloret e Komunës;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore të drejtorisë;
- Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe marrja e masave për ngritjen e efikasitetit të vazhdueshëm të administratës;
- Rritja e stafit për shërbime administrative për qytetart e Komunës së Ferizajt;
- Trajnimi i punëtorëve të administratës me qëllim të rritjes së cilësisë në punë ;
- Transkriptim automatik për Komunën e Ferizajt;
- Sigurimi fizik i objektit të Komunës dhe objekteve tjera që janë në kuadër të Komunës;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës;
- Furnizim dhe instalim i ngrohjes qendrore me pompa termike në objektin e Komunës;
- Krijimi i hapësirës dhe kushteve për rregullimin e arkivës për arkivimin e lëndëve të Administratës Komunale;
- Krijimi i hapësirës për depo të materialit shpenzues së Administratës Komunale ;
- Furnizim me paisje dhe mirëmbajtje TIK;
- Furnizim me inventarë të ri sipas nevojës brenda objektit të Komunës;
- Ngritja e shërbimeve për qytetareve e veçanërisht ndaj bashkatdhetarëve;
- Furnizimi me E-Kioska dhe mirëmbajtja e saj;
- Konsultimet e rregullta me shoqërinë civile dhe bashkëpunimi në avancimin e vazhdueshëm të proceseve;

- Furnizim me lëndë djegëse dru dhe pelet të objekteve institucionale në kuadër të Komunës së Ferizajt;
- Furnizim me material shpenzues administrative ;
- Furnizim me letër të bardhë për zyret e Administratës Komunale;
- Mirëmbajtja - servisimi dhe mbushja aparateve kundër zjarrit në kuadër të Komunës së Ferizajt;
- Furnizim me certifikata të Gjendjes Civile sipas udhëzimit administrative të MPB/ARC;
- Transporti me autobus (brenda dhe jashtë vendit) i punëtorëve të administratës komunale, shkollave dhe institucioneve tjera në Komunën e Ferizajt;
- Regjistrimi i automjeteve të Administratës Komunale, QKMF-se dhe BZ-se në Komunën e Ferizajt;

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Znj.Agnesa Hajredini